

Përndjekja e Kristofor Kisit, Kryepiskopit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nën Regjimin komunist

Dr. Thoma Shkira

(Kolegji niversitar Logos)

BIO

Lektor Ph.D. Thoma Shkira ka lindur në Korçë më 15 Prill 1984. Në vitin 2009 është diplomuar me “Shkëlqyer” në Universitetin Kombëtar Kapodistria të Athinës në degën Theologji Sociale. Në vitin 2022 fitoi titullin shkencor Doktor i Shkencave me vlerësimin “Shumë mirë”, specialiteti Histori në Fakultetin e Histori – Filologjisë, Universiteti i Tiranës.

Që prej vitit 2009 e në vazhdim angazhohet si pedagog në Akademinë Teologjike ‘Ngjallja e Krishtit’, Shën Vlash Durrës mbi Historinë e Artit dhe Hagjiologjinë dhe që prej vitit 2018 si pedagog në KU “Logos”. Ka objekt studimi: Trashëgiminë Religjioze dhe Kulturore të Monumenteve; Historikun e Bashkësisë Orthodhokse në Shqipëri dhe përndjekjen e figurave klerike dhe laike gjatë Regjimit komunist. Pjesëmarrës dhe referues në takime ndërfetare dhe konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Abstrakt

Punimi shtjellon përndjekjen politike të ish – Sigurimit të Shtetit ndaj klerikut të lartë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Kristofor Kisit, nën Regjimin komunist. Në punim sillen fakte të shkarkimit me “puç” të Kryepiskopit Kristofor Kisi më 25 gusht 1949, largimit të tij nga veprimtaria kishtarë dhe izolimit të tij në Kishën e shën Prokopit në Tiranë deri sa vdiq në rrethana të dyshimta më 17 qershor 1958. Gjithashtu në një vështrim përshkrues dhe krahasues ceket dhe përndjekja e klerikëve të lartë, Visarion Xhuvanit dhe Irine Banushit.

Metodologjia e shtjellimit të këtij punimi është përshkruese dhe analizuese e të dhënave të konsultuara me bibliografinë përkatëse si dhe në dokumentet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Arkivit Qëndror Shtetëror (AQSh). Gjithashtu analizohen të dhënat e dokumenteve, shtypit të kohës dhe intervistave të personave të ndryshëm.

Qëllimi i punimit është të pasqyrojë fakte mbi përndjekjen e Kryepiskopit Kristofor Kisit nën Regjimin komunist. Hidhet dritë mbi dorëheqjen e imponuar të Kristofor Kisit nga pozicioni i Kryepiskopit dhe aspekte të përndjekjes politike të ish – Sigurimit të Shtetit shqiptar. Largimi i Kristofor Kisit nga drejtimi i Kishës Orthodhokse dëshmon depërtimin e njerëzve të Regjimit komunist në strukturën e brendshme kishtare dhe mbajtjen nën kontroll të Institucionit të Kishës Orthodhokse deri në likuidimin tërësor të tij në vitin 1967.

Fjalë kyçe: Përndjekja e klerit të lartë ortodoks, Regjimi komunist, Ish – Sigurimi i Shtetit Shqiptar 1944-1990, Kristofor Kisi, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë